



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 334 prot

Ballsh më 22/01/2026

Nr. 01 datë 22 / 01 / 2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 22 / 01 / 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 29 / 01 / 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Mexhari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 334 / prot.

Ballsh më 22.01.2026

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën Enjte, datë 29.01.2026, ora 14:00, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 23.12.2025.
3. **Projektvendim Nr.01:** Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trjtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën me fondet e pushtetit qendror dhe vendor për vitin 2026.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.

4. **Projektvendim Nr.02:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i Ekonomisë.

5. **Projektvendim Nr.03:** Për miratimin e listës së përfaqësuesve të Bashkisë Mallakastër në bordin e Institucionit Arsimor Mallakastër.

6. **Komisioni për shqyrtim: Komisioni i Arsimit..**

7. **Projektvendim Nr.04:** Për pagesën e vlerës së qirasë familjes së Z.Arjan Shehaj, banori fshatit Damës, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i Emergjencave.

8. **Projektvendim Nr.05:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i Ekonomisë.

9. **Projektvendim Nr.06:** Për miratimin e një shtese e rishpërndarje të fondeve buxhetore për vitin 2026, nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i Ekonomisë.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

